



KATALOGU I PROVIMIT  
**G J U H Ë S H Q I P E**  
**D H E L E T Ë R S I**

PROVIMI PROFESIONAL NË SHKOLLAT PROFESIONALE KATËRVJEÇARE

VITI SHKOLLOR 2009/2010

**Katalogun e provimit e përgatiten:**

**Hava Pereziaqi**, SHMP „V.Bashkimi” Ulqin  
**Mr. Rrok Gjolaj**, Gjimnazi „25 Maji” Tuz  
**Mr. Haxhi Shabani**, Gjimnazi „Drita” Ulqin  
**Sehad Lulanaj**, Gjimnazi „25 Maji” Tuz  
**Luigj Berisha**, Qendra e Provimeve, Podgoricë

## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje.....	4
2. Rregullat .....	5
3. Qëllimet e përgjithshme .....	6
4. Struktura dhe vlerësimi i provimit .....	7
4.1. Skema e provimit .....	7
4.2. Tipet e detyrave/pyetjeve .....	7
5. Përmbajtja e provimit dhe qëllimet .....	8
5.1. Gjuhë .....	8
5.2. Letërsi .....	8
5.3. Të shprehurit me shkrim .....	8
5.4. Veprat letrare të obliguara .....	9
6. Shembulli i testit .....	10
7. Fleta për përgjigje .....	16
8. Zgjidhja e testit me skemë për vlerësim .....	17
9. Literatura .....	21

# 1. HYRJE

Matura Shtetërore në sistemin arsimor të Malit të Zi fillon të futet në vitin shkollor 2009/2010 dhe paraqet vërtetimin ekstern të standardizuar të arriturave shkollore të nxënësve në fund të arsimimit katërvjeçar të shkollës së mesme profesionale. Ligji për arsimin profesional (Gazeta zyrtare e RMZ nr.49/07, nenet 6 dhe 82) ka paraparë që shkollimi sipas programeve për arritjen e shkollës së arsimimit të mesëm profesional, në kohëzgjatje prej katër vjetësh, të përfundojë me dhënien e provimit profesional. Provimi profesional jepet në mënyrë ekstere, kurse për përgatitjen e materialit të provimit dhe zbatimit të procedurës së Maturës Shtetërore është e ngarkuar Qendra e Provimeve.

Në fund të vitit shkollor 2008/2009, nxënësit e vitit të tretë të shkollës së mesme profesionale do të japin provimin ekstern të pilot Maturës. Në këtë provim verifikohen dijet, aftësitë dhe shkathhtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të programit të lëndës të cilat duhet ti dinë nxënësit në fund të vitit të katërt.

Katalogu i provimit hollësisht e përshkruan provimin nga gjuha shqipe dhe letërsia dhe i kushtohet nxënësve dhe mësimeve.

Në katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse me formën e qëllimeve të provimit saktësisht është thënë përmbajtja e lëndës e cila do të pyetet. Është ofruar shembulli i testit me skemën e detajuar për vlerësim.

## 2. RREGULLAT

Provimi nga gjuha shqipe dhe letërsia do të mbahet në kushte të njëjta dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e vitit të dytë dhe të tretë të shkollës së mesme profesionale.

Është paraparë që nxënësi të ulët vetëm në bankë dhe që rendi i bankave në klasa të mësimit të jetë i tillë që më së shumti në një hapsirë të vendosen 15 nxënës.

Materiali i provimit do të pakëtohet në qese të veçanta dhe të sigurta, të cilat do të hapen para nxënësve menjëherë para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet:

- prezantimi i rrejshëm,
- hapja e detyrave të provimit para kohës së lejuar,
- pengimi i nxënësve tjerë,
- shfrytëzimi i mjeteve të palejuara,
- dëmtimi i shifrës në librezën e testimit,
- mosrespektimi i shenjës për përfundimin e provimit.

Mjetet e lejuara: lapsi i thjeshtë, goma dhe lapsi kimik/stilolapsi.

Punimi i nxënësit duhet të jetë i shkruar me laps kimik/stilolaps.

### 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Pas përfundimit të vitit të katërt të shkollës së mesme profesionale, nxënësi duhet:

- të njohë normën gjuhësore:atë drejtshkrimore e drejtshqiptimore dhe t'i zbatojë ato me përpikmëri
- të mësojë konceptet themelore gramatikore dhe të di t'i zbatojë gjatë komunikimit (me shkrim dhe me gojë)
- të kuptojë strukturat përmbajtësore dhe format e tekstit letrar dhe jo letrar
- të vlerësojë i pavarur tekstin,të shpjegojë dhe argumentojë pohimet e veta
- të interpretojë dhe të analizojë tekstet letrare me shkrim dhe me gojë nga shkrimtarët e paraparë
- të di të shkruajë në llojet e ndryshme stilistike:posaçërisht në stilin letrar dhe publicistik
- të di të dallojë figurat stilistiko letrare në veprat letrare

## 4. STRUKTURA DHE VLERËSIMI I PROVIMIT

### 4.1. Skema e provimit

(provimi zgjatë 60 minuta dhe punohet pa pushim)

#### Detyrat/pyetjet nga gjuha shqipe dhe letërsia

Përmes detyrave dhe pyetjeve nxënësi duhet të tregojë se

- e kupton përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit letrar/përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit jo letrar
- di të analizojë tekstin (pjesën apo fjalinë)
- di të zbatojë drejt rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

### 4.2. Tipet e detyrave/pyetjeve

#### □ detyrat/pyetjet e tipit të mbyllur

- detyrat/pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (janë ofruar tri apo katër përgjigje prej të cilave një është e saktë)
- detyrat/pyetjet e zgjidhjes alternative (pyetjet PO - JO apo E SAKTË - E PASAKTË)
- detyrat/pyetjet që bashkohen (fjalët janë të grupuara në dy kolona dhe duhet të bashkohen drejtë)

#### □ detyrat/pyetjet e tipit të hapur

- detyrat/pyetjet e përgjigjes së shkurtër (duhet shkruar fjalën, sintagmën, fjalinë apo shpjeguar diçka në dy-tri fjali)
- detyrat/pyetjet e përgjigjes së gjatë (hartimi i esesë, shkrimi i tekstit funksional)

Tipi i detyrave	Gjuhë	Letërsi	Të shprehurit me shkrim	Gjithsej
Detyrat e tipit të mbyllur	5 – 10	3 – 6	–	8 – 16
Detyrat e tipit të hapur	5 – 10	6 – 12	1 – 2	12 – 24
<b>Gjithsej</b>	<b>10 – 20</b>	<b>9 – 18</b>	<b>1 – 2</b>	<b>20 – 40</b>

**Vërejtje:** provimi i maturës përbëhet nga pjesa eksterne dhe ajo interne. Pjesën eksterne (80%) e zbaton Qendra e Provimeve, kurse pjesën interne (20%) shkolla. Pjesa interne e provimit këtë vit **nuk do të organizohet**.

## 5. PËRMBAJTJA E PROVIMIT DHE QËLLIMET

Nxënësi duhet të përgjigjet në pyetje lidhur me tekstin e lexuar sikurse është: ftesa, kërkesa, ankesa, letra, lajmi, intervista, reklama, jetëshkrimi, portreti, tekstit dhe fragmenti letrar.

### 5.1. GJUHË

Nxënësi duhet të di

- të bëjë klasifikimin gjenetik të gjuhëve dhe gjuhës shqipe në kuadër të familjes së gjuhëve indoevropiane.
- zhvillimin historik të gjuhës shqipe në periudha të ndryshme.
- dialektet e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat.
- fonetikën e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat.
- morfologjinë e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat.
- sintaksën e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat.
- të njohë drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e gjuhës shqipe.
- të njohë dhe të zbatojë rregullat e shenjave të pikësimit.

### 5.2. LETËRSI

Nxënësi duhet të di

- që nga shembulli i tekstit të dhënë të përcaktojë: autorin, subjekti lirik, personazhet (ndarjen e tyre temën, motivin).
- në një tekst të dhënë të dallojë: gjinitë letrare (lirikën, epikën, dramatikën) dhe llojet e letërsisë.
- që të njohë periudhat letrare nga antika deri te letërsia bashkëkohore (përfaqësuesit kryesorë dhe veçoritë stilistike), të bëjë dallimin e veçorive stilistike të periudhave letrare.
- të veçojë figurat stilistike në tekst (krahasimin, epitetin, hiperbolën, anaforën, metaforën, alegorinë, ironinë).
- të njohë elementet e vargëzimit (rimën dhe ritmin).
- të njohë dhe të dallojë nocionet: përmbajtjen, fabulën, syzheun.
- të di të dallojë natyrën e poezisë, prozës dhe dramës.

## KULTURA E GJUHËS NË PRAKTIKË

### 5.3. TË SHPREHURIT ME SHKRIM

Nxënësi të di të shkruajë: kërkesën, letrën jozyrtare, urimin, lajmin.

Nxënësi të respektojë:

- udhëzimet për shkrim të tekstit, formën e tekstit dhe parimet e formulimit (hyrjen, përpunimin, përfundimin, shkrimin e emërtimeve të vendeve, datave, adresave, emrin dhe mbiemrin e të adresuarit).

#### 5.4. VEPRAT LETRARE TË OBLIGUARA

- Sofokliu** - „Antigona”  
**Shekspiri** - „Romeo dhe Zhulieta”  
**M.Barleti** - „Historia e Skenderbeut” (fragment)  
**Bajroni** - „Çajld Haroldi” (fragment)  
**P.P.Njegosh** - „Kurora e maleve” (fragment)  
**N.Frashëri** - „Bagëti e Bujqësia”  
**A.Z.Çajupi** - „Pas vdekjes”  
**N.Mjeda** - „Andrra e jetës”  
**Sharl Bodleri** - „Albatrosi”  
**Lasgush Poradeci** - „Vdekja e Nositit”  
**Migjeni** - „Poema e mjerimit”  
**Gj.Fishta** - „Lahuta e Malësisë”  
**I.Kadare** - „Gjenerali i ushtrisë së vdekur”  
**D.Agolli** - „Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”  
**A.Podrimja** - „Drejtpehimi”  
**A.Kamy** - „I huaji” (fragment)

## 6. SHEMBULLI I TESTIT

1. Cilat janë normat kryesore të gjuhës letrare shqipe?

.....

(1 pikë)

2. Lexo tekstin, pastaj përgjigju në pyetjet 2, 3 dhe 4.

### MARIE CAMAJ NDËR MË TË MIRËT

Fakulteti për Studime Shtetërore dhe Europiane në Podgoricë ka shpallur ditë më parë 5 studentë më të mire të vitit, në mesin e të cilëve është edhe Marie Camaj nga Tuzi, studente e vitit të tretë. Me këtë rast kryebashkiaku i Podgoricës, Miomir Mugosha, i ka shpërblyer ata me nga një llap top.

(Pjesë nga „Koha javore”, 25 shtator 2008)

Teksti është:

1. raport
2. lajm
3. njoftim

Rretho përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

3. Kujt i kushtohet ky tekst?

.....

(2 pikë)

4. Rretho „PO”ose „JO” në tabelë për pyetjet nga teksti „Marie Camaj ndër më të mirët”!

Studentët më të mirë të vitit	Marie Camaj ndër më të mirët
Fakulteti për Studime shtetërore dhe Europiane ka shpallur 6 studentët më të mire të vitit	PO / JO
Studentët u shpërblyen me nga 2 llap top	PO / JO
Marie Camaj ishte në mesin e pesë studentëve më të mirë	PO / JO
Studentët u shpërblyen me nga një llap	PO / JO

(1 pikë)

5. Kur k-ja njëjës në fund të fjalës bëhet q në shumës kemi:

1. palatalizim
2. rotacizëm
3. apofoni

Rretho përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

**6. Biseda në mes të dy a më shumë personave është::**

1. dialog
2. prolog
3. monolog
4. epilog

(1 pikë)

**7. Kur ironia quhet sarkazëm?**

.....

(1 pikë)

**8. Në fjalitë e mëposhtme përdor shkronjën e madhe.**

Në qendrën e kulturës në ulqin u mbajt një veprimtari kulturore me rastin e javës së fëmijëve e cila në mal të zi kremtohet javën e parë të muajit tetor. Organizimi i këtij aktiviteti ka për qëllim shënimin simbolik të pranimit të nxënësve të klasëve të para në lidhjen e fëmijëve.

.....  
.....  
.....  
.....

(2 pikë)

**9. Cilin shkrimtarss të Rilindjes e quajmë „Bilbili i gjuhës shqipe”?**

1. Ndre Mjedën
2. Konstantin Kristoforidhin
3. Naim Frashërin
4. Çajupin

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**10. Fjala letërsi vjen nga fjala latine:**

1. litera
2. literarum
3. letera
4. literature

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**11. Shkruaj drejtë fjalët:**

Çthur .....  
Çvulos .....  
Çdredh .....  
Çqep .....

(1 pikë)

**12. Përmirëso në gjuhën standarde fjalët!**

Sod .....  
E gjanë .....  
Asht .....  
Kam ba .....

(1 pikë)

**13. Rretho përgjigjen e saktë të ndarjes së fjalës në fund të rreshtit.**

1. hekur-udhë
2. heku-rudhë
3. hekur-udhë

(1 pikë)

**14. Përcakto llojin e veprës „Pas vdekjes”!**

.....

(1 pikë)

**15. Shkruaj emrin e autorit të veprës „Pas vdekjes”!**

.....

(1 pikë)

**16. Cilët janë personazhet kryesor të veprës „Pas vdekjes”?**

.....

(1 pikë)

**17. Përcakto epokën letrare që i takojnë këta shkrimtarë:**

Marin Barleti .....  
Jeronim de Rada .....  
Mitrush Kuteli .....

(1 pikë)

**18. Shkruaj sipas dëshirës një urim. Bëj kujdes për formën dhe drejtshkrimin. Urimi duhet të ketë deri në 10 fjalë.**

.....  
.....  
.....  
.....

(3 pikë)

**19. Në fjalinë e mëposhtme përdor emrin në rasën dhanore:**

Agroni nuk mund të ndahej prej .....

(1 pikë)

**20. Kur zanorja a ndërron në e kemi:**

1. apofoni
2. palatalizim
3. metafori

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**21. Lexo tekstin me kujdes dhe pastaj kryej detyrën!**

-Tufa, more shoktë e mi, na iki gjysa e saj! -thot Hamdiu dhe pa mbaru mir fjalët, u hedhë pas një shkëmbi, ku u rrokullisë s'i t'ishte një gurë l madhë. Të katër barinjët sdukeshin më.

Më bëhet sikur barinjët, dhit e qenët, që të gjith qen strukë e zbënin zë...

**Përmirëso gabimet në tekst!**

.....  
.....  
.....  
.....

(4 pikë)

**22. Poezinë „Albatrosi” e ka shkruar:**

1. A. Rembo
2. S. Malarme
3. P. Verleni
4. Sh. Bodleri

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**23. Shkruaj drejt shkurtesat e këtyre fjalëve!**

- Filozof .....
- Centimeter .....
- Bie fjala .....
- Bashkimi European .....
- Tiranë .....
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve .....

(1 pikë)

**24. Si quhen fjalët me prejardhje nga gjuhët e huaja?**

1. sinonime
2. huazime (arkaizma, zhargonizma)
3. antonime

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**25. Fjalët përnga struktura ndahen në:**

1. fjalë të parme dhe jot ë parme
2. fjalë të ndërmjetme
3. fjalë kuptimplota
4. fjalë shërbyese

*Rretho përgjigjen e saktë.*

(1 pikë)

**26. Ç' kuptojmë me kompozicion të veprave letrare?**

.....

(1 pikë)



## 7. FLETA PËR PËRGJIGJE

Nxënësit bashkë me testin do të fitojnë edhe listën për shënimin e përgjigjeve në detyratme zgjidhje të shumëfishtë. Është e nevojshme që në vendin e duhur **ME KUJDES** të përshkruajnë përgjigjet e tyre.



### PROVIMI PROFESIONAL FLETA PËR PËRGJIGJE Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu:



	1	2	3
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
22.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
24.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
25.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
29.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shembulli i fletës me shënimin e saktë të përgjigjeve të nxënësve



PROVIMI PROFESIONAL  
FLETA PËR PËRGJIGJE  
Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu:

	1	2	3
2.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
5.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
6.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
10.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
13.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	1	2	3	4
22.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	1	2	3
24.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
25.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
29.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

## 8. ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMËN PËR VLERËSIM

1.  
Norma drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore  
**1 pikë**

2.  
2. Lajm  
**1 pikë**

3.  
Nxënësi di se teksti i kushtohet lexuesve të „Kohës javore”  
**Numri maksimal i pikëve: 2**  
Nxënësi e di se teksti i kushtohet lexuesëve Por në përgjigje nuk e cekë emrin e gazetës.  
**Numri i pjesshëm i pikëve: 1**  
Tregon kuptim të gabueshëm APO jep përgjigje të pamjaftueshme OSE përgjigje të papërcaktuar.  
→ „Kohës javore”.  
→ Studentëve.  
→ Nxënësve. (apo përgjigje të ngjashme)  
**0 pikë**

4.

Studentët më të mirë të vitit	Marie Camaj ndër më të mirët
Fakulteti për Studime shtetërore dhe Europiane ka shpallur 6 studentët më të mirë të vitit	PO / <input checked="" type="radio"/> JO
Studentët u shpërblyen me nga 2 llap top	PO / <input checked="" type="radio"/> JO
Marie Camaj ishte në mesin e pesë studentëve më të mirë	<input checked="" type="radio"/> PO / JO
Studentët u shpërblyen me nga një llap top	<input checked="" type="radio"/> PO / JO

Të gjitha përgjigjet e sakta me këtë renditje: JO, JO, PO, PO = **1 pikë**

5.  
1. Palatalizim  
**1 pikë**

6.  
1. Dialog  
**1 pikë**

7.  
Kur shpreh hapur përbuzjen dhe urrejtjen  
**1 pikë**

8.  
Në Qendrën e Kulturës në Ulqin u mbajt një veprimtari kulturore me rastin e Javës së Fëmijëve e cila në Mal të Zi kremtohet javën e parë të muajit tetor.  
Organizimi i këtij aktiviteti ka për qëllim shënimin simbolik të pranimit të nxënësve të klasëve të para në Lidhjen e Fëmijëve.  
**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në të gjitha fjalët = 2 pikë**  
**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në të paktën 6 fjalë = 1 pikë**  
**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në më pak se 6 fjalë = 0 pikë**

**9.**

3. Naim Frashëri

**1 pikë**

**10.**

1. Litera

**1 pikë**

**11.**

Shthur, zhvulos, zhdredh, shqep

**1 pikë**

**12.**

Sot, e gjerë, është, kam bërë

**1 pikë**

**13.**

2. heku-  
rudhë

**1 pikë**

**14.**

Komedi

**1 pikë**

**15.**

A. Z. Çajupi

**1 pikë**

**16.**

Adhamudhi, Zeneli, Vurko, etj

**1 pikë**

**17.**

M. Barleti....Humanizmit

J. de Rada..Rilindjes

M. Kuteli.....Realizmit

**1 pikë**

**18.**

Urimi deri në 10 fjalë = **1 pikë**

Respektimi i formës së urimit = **1 pikë**

Respektimi i normës gjuhësore (rasave, renditjes së drejt të gjymtyrëve të fjalisë, përdorimi i shkronjës së madhe, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras...) = **1 pikë**

**Gjithsej 3 pikë**

**19.**

Agroni nuk mund të ndahej prej librit.

**1 pikë**

**20.**

3. Metafoni

**1 pikë**

**21.**

- Tufa, more shokët e mi, na iku gjysma e saj! - thotë Hamdiu dhe, pa mbaruar mirë fjalët, u hodh pas një shkëmbi, ku u rrokullisë si të ishte një gur i madh. Të katër barinjtë, dhitë e qenjtë, që të gjithë qenë strukur e nuk bënëin zë...

**Të gjitha gabimet e përmirësuar = 4 pikë**

**22.**

4. Bodleri

**1 pikë**

**23.**

Fil., cm., b. f., BE, TR, KQZ

**1 pikë**

**24.**

2. huazime (arkaizma, zhargonizma)

**1 pikë**

**25.**

1. fjalë të pame dhe jo të pame

**1 pikë**

**26.**

Ndërtimin e veprës letrare

**1 pikë**

**27.**

„Vallja e yjeve”

**1 pikë**

**28.**

Lasgush Poradeci

**1 pikë**

**29.**

3. protezë

**1 pikë**

**30.**

Kërkesa deri në 40 fjalë = **1 pikë**

Respektimi i formës sëkërkesës = **1 pikë**

Respektimi i normës gjuhësore (rasave, renditjes së drejt të gjymtyrëve të fjalisë, përdorimi i shkronjës së madhe, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras...) = **1 pikë**

**Gjithsej 3 pikë**

Tipi i detyrave	Gjuhë	Letërsi	Të shprehurit me shkrim	Gjithsejtë
Detyrat e tipit të mbyllur	4	5	–	9
Detyrat e tipit të hapur	9	10	2	21
<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>30</b>

Numri i përgjithshëm i pikëve në test: **39** (100 %)

## 9. LITERATURA

- Rami Memushaj, „Bukuria e gjuhës”, Gjuha shqipe për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Podgoricë, 2007
- Rami Memushaj, „Bukuria e gjuhës”, Gjuha shqipe për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm, Podgoricë, 2008
- Ardian Marashi, „Letërsia 1”, për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Podgoricë, 2007
- Prof. Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Rilindja, 1989
- Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë - Instituti i gjuhës dhe i letërsisë- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë, 1976
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20 - 25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1974
- Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja-Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1989
- Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III, Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1986
- Milivoj Solar, Teoria e letërsisë, Rilindja - Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1978
- Jani Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë 1978
- Bahri Beci, Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, SHB DITURIA, 2002







qendra e provimeve  
MASA E  
VËRTETË E  
NJOHURIVE

Vaka Đurovića bb, 81 000 Podgorica  
[ic@iccg.edu.me](mailto:ic@iccg.edu.me), [www.iccg.edu.me](http://www.iccg.edu.me)